


e pramuar 10.05.2017
[Signature]



KL.	5214
NR.	
DT.	10.05.2017
OR.	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	05.05.2017
REFERENC-Ë:	Nr.50/4
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren <i>[Signature]</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë <i>[Signature]</i>

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturore nr.21/2017 të dt. 26.04.2017 për lëndën Anton Berisha Nr.04-070/50-13102 për ndërtimin e shtëpisë individuale në ngastrën kadastrale Nr. 3872-0

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.

Arsyetim

Anton Berisha nga Prizreni ka parashtruar kërkesën për ndërtimin e shtëpisë individuale në ngastrën kadastrale me Nr.3872 – 0. Etazhiteti i objektit ekzistues është B+P, pjesërisht i djegur aksidentalisht para disa jave. Objekti i lartëcekur gjendet në zonën e VIII-të sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Qendres Historike te Prizrenit, ku etazhiteti i lejua është P+2 (lartësia maksimale deri te streha është 9.5m) dhe për ndërtim mund të shfrytëzohet 60% e sipërfaqës së parcelës. Në afërsi të parcelës për ndërtim nuk ka ndonjë objekt që është në listën e MKRS-së. “Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme” (10.10.2016 – 10.10.2017). Objekti është në rrugën “Anton Qetta” me nr.19.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka rekomanduar si në vijim:

1. Aprovohet Projekti Ideor për për ndërtimin e shtëpisë individuale në ngastrën kadastrale me Nr.3872 – 0, i cili i përmbush kriteret për ndërtime të reja në zonën VIII – të sipas planit të konservimit dhe zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit.
2. Pala gjatë përpilimit të projektit kryesor, duhet të ketë parasysh që lartësia maksimale deri te streha është 9.5m nga niveli 0 i terrenit, pjerrtësia e kulmit duhet të jetë nga 20° - 30° dhe ndërtesa të jetë në harmoni me arkitekturën tradicionale.
3. Njoftohet pala se Projektin Kryesor, të Projektit Ideor të miratuar nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, duhet ta dorëzojë në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore (QRTK) – Prizren për verifikim (të gjitha kopjet e projektit që i nevojiten palës). Dy kopje dixhitale dhe dy kopje fizike të projektit kryesor mbeten në QRTK - Prizren (një për QRTK - në dhe një për IKMM – në).

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM –së;
- Arkivit të IKMM –së;
- Arkivit të MKRS – së;

Agim Gërguri
U.D. Drejtor





206 04.05.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 21/2017 ✓
Datë: 26.04.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi, 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: “Miratimi i projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale në ngastrën kadastrale me Nr. 3872 – 0, Z.K. Prizren me pronar Anton Berisha”.
2. Në bazë të rekomandimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues, i cili duhet të dorëzohet dhe miratohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas Projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e një eksperti nga Qendresa Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.